



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.73, datë 24.04.2023

PËR

“MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË ADMINISTRATËS SË
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 178 pika 2, nenit 176 pika 4 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.84/2022, “Për Buxhetin e vitit 2023”, nenin 50 pika 3 të ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Udhëzimin Nr.1, datë 01.03.2016, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit” i ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë sipas lidhjes Nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi konform legjislacionit në fuqi, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Vendimi Nr.36, datë 06.03.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë të Prokurorisë” shfuqizohet.
4. Të njoftohen për këtë vendim administrata e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 24.04.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Arta Mandro

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza